



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Tiranë, më \_\_.04.2020

**NJOFTIM**

Enti Rregullator i Energjië, i është përgjigjur thirrjes së Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë për t'iu bashkuar nismës së Kuvendit të Shqipërisë për përgjysmimin e pagave të drejtuesve të lartë, si një kontribut në lehtësimin e përballimit të nevojave për parandalimin e përhapjes së këtij virusi të rrezikshëm.

ERE ka qënë dhe do të jetë një mbështetëse e inisiativave që synojnë të kontribuojnë në rimëkëmbjen si dhe lehtësimin e efekteve financiare që fatkeqësitë natyrore si tërmeti i fundvitit dhe epidemia e shkaktuar nga virusi Covid 19 kanë shkaktuar në Shqipëri. Për sa më sipër, Bordi I ERE ka vendosur në mbledhjen e datës 08.04.2020, që Anëtarët e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë, gjatë periudhës së epidemisë së shkaktuar nga Covid 19 e deri në përfundim të saj, por jo më shumë se 3 muaj, do të përfitojnë pagë mujore neto në masën 50 % të pagës mujore neto aktuale.

Me respekt,

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**